

Funksioni i disa fjalëve në njësi sintaksore

Mr. Agim Spahiu

31 mars 2000

Përmbledhje

Në këtë shkrim jemi ndalur kryesisht në funksionin sintaksor të disa pjesëve në gjuhën shqipe, çështje kjo jo shumë e trajtuar në gjuhësinë shqiptare.

Në këtë shkrim do të bëjmë fjalë për funksionin sintaksor të fjalëve: **pohuese** *po*, **mohuese** *jo*, **dyshuese** *ndoshta*, *mbase*, *kushedi*; **dëftuese** *ja e qe* dhe **përsëritëse** *falemnderit*, *mirupafshim* etj., të cilat në gramatikat e gjuhës shqipe janë konsideruar si **fjali të pagjymtyrëzueshme**. Në gjuhën gjermane këto fjalëza konsiderohen si **ekuivalente fjalish** (Satzäquivalente), kurse në gjuhën frënge kryesisht **si fjalë - fraza** (Le mot - phrase).

Këtu do të ndalemi kryesisht në çështjen e përdorimit të tyre në ato njësi sintaksore, kur: **1. ato varen nga gjymtyrë të tjera**; dhe **2. kur ato janë në pozicionin e gjymtyrës kryesore**.

Kjo çështje vetëm sa është prekur kalimthi në tekstin universitar **Gramatika e gjuhës shqipe 2, Sintaksa**. Aty, në mes tjerash, thuhet se

fjalitë e pagjymtyrëzueshme mund të jenë edhe fjali të një periudhe asindetike a me bashkërenditje ose fjali kryesore të një periudhe me nënrenditje; ato mund të pasohen nga fjali të tjera që plotësojnë kuptimin e tyre ose e bëjnë më të qartë duke e zërthyer në formë të një fjalie të zakonshme. Disa fjali të pagjymtyrëzueshme, thuhet më në fund, si ato të pohimit e të mohimit, mund të dalin edhe si fjali të varura në një periudhë me nënrenditje¹.

Dhe e gjithë kjo është ilustruar me shembullin: (*E pyeta nëse do të vinte*). Më tha se **po**².

¹Shih *Gramatika e gjuhës shqipe, 2, Sintaksa*, Tiranë, 1997, f. 408.

²Po aty, f. 408.

1 Disa raste kur disa nga këto fjalëza janë gjymtyrë të varura

Këtu kemi të bëjmë me fjalëzat **po** e **jo** të cilat në kontekste të caktuara mund ta kenë vlerën e fjalive të varura kundrinore. P. sh.: Unë po them (**se**) **po** /**jo**. Unë mendoj **se po** / **jo**.

Në këta dy shembuj, fjalëzat **po** e **jo** në raport me gjymtyrët e tjera paraprijëse, janë në funksion të fjalive të pagjymtyrëzueshme të varura kundrinore.

Këto përgjigje të bashkëbiseduesit jepen në këtë mënyrë të shkurtër, me qëllim që të mos përsëritet e gjithë ajo që thotë folësi a personi që e shtron një çështje për bisedim ose në formë pyetjeje. Pra, kjo bëhet, mendojmë, për arsye të ekonomisë gjuhësore, ndonëse në stilin libror e shkencor këto ndërtime nuk janë shumë të zakonshme.

Më rrallë këto fjalëza mund të dalin edhe me vlerën e fjalive të varura kryefjalore, p. sh.: - A mund të ketë jetë në Mars? - pyeti Agroni. - Mendohet **se po**, - u përgjigj astronomi.

Të ngjashme janë edhe ndërtimet: - Thuhet **se po**. / Flitet **se jo**; etj.

Nga këto ndërtime mund të vihet re se në fjalinë kryesore a drejtuese mbizotërojnë foljet- kallëzues të tipit *them*, / *thuhet*, *mendoj*/ *mendohet*, *kujtoj*, *flitet* etj.

Edhe më të rralla janë përgjigjet me përgjegjëset e fjalive me: **ndoshta**, **mbase**(P. sh.: - A mund të ketë jetë në Mars? , - pyeti Agroni. - Unë them: **ndoshta**).

2 Disa raste kur disa fjalëza janë vetë gjymtyrë kryesore, kurse të tjerat varen prej tyre

Këtu kemi të bëjmë me fjalëzat sinonimike **ja** e **qe**, të cilat dalin me vlerën e fjalive kryesore a drejtuese, ndërsa elementet e tjera janë të varura. P. sh.: **Ja** se si ndodhi puna; **Ja** si i tregonte vetë disa ngjarje të vegjëlisë së tij; **Ja** se ku ka arritur! **Qe** si u bë kjo; **Qe** se për çka bëhet fjalë këtu; **Vallë** si do t'ia dalim kësaj pune? ! etj.

Në këto raste, nga këto fjalëza kryesisht varen fjalitë kundrinore. Këto fjalëza semantikisht mund të jenë sinonimike me foljet: *shoh/shihni*; *shiko/shikoni*, kurse fjalëza **vallë** me foljen **a thua** etj.

Për dallim nga ndërtimet e lartshënuara, njësitë sintaksore që nisin me këto fjalëza, po përdoren edhe në stilin libror e shkencor, p. sh.: **Ja** se si mund të paraqitet kjo në mënyrë tabelare. (Nga një shkrim shkencor- teknik).

Fjalëza **qe** përdoret kryesisht në të folmet dialektore të Veriut. P. sh. **Qe** çka na tha filani: ... **Qe** çka i bamë vetit; etj.

Nga kjo fjalëz mund të varet edhe një gjymtyrë e varur e fjalisë. P. sh.: Kuptoj, z. Agron, kuptoj. Do të punojmë, si asnjëherë më parë. **Qe** dorën.

Në shembullin e fundit, fjalëza **qe** nuk mund ta ketë kuptimin e foljeve *shoh*, *shikoj* etj. Këtu kemi të bëjmë me një pjesëz dëftuese që lidhet me një kundrinë të drejtë (*dorën*), por që në kontekst nënkuptohet folja- kallëzues *të ta jap*. Pra, kjo, sipas mendimit tonë, duhet konsideruar si një fjali eliptike. Edhe në shembullin: **Qe** shkolla, **qe** nxënësit, **qe** edhe mësuesi; fjalëza **qe** duhet ta ketë vlerën e një pjesëze dëftuese.

Në anën tjetër, edhe shprehjet përshëndetëse, të ashtuquajtura pasthirrma në grammatikat e gjuhës sonë si: *falemnderit, mirupafshim, mirë se erdhët, ditën e mirë, udha e mbarë* etj., në ligjërimin e përditshëm mund të jenë gjymtyrë kryesore për gjymtyrë të tjera të varura. P. sh.: **Falemnderit** për ndihmën tuaj (=për ndihmën tuaj - kundrinor i drejtë); **Të falemnderit** shumë (=shumë - rrethanor sasi); **Falemnderit** për ndihmën që më dhatë. (=që më dhatë - fjali e varur përcaktore), **Mirupafshim** në Kosovën e lirë; (=në Kosovën e lirë - rrethanor vendi/ për analogji kemi edhe: **Mirë se erdhët** në Kosovën e lirë). Këto të fundit më rrallë shoqërojnë fjali të varura.

Këto fjalëza përshëndetëse ende ruajnë nga një bërthamë foljore me elementet e tjera që kanë pavarësi kuptimore. Prandaj, këto thjesht duhet të konsiderohen **fjali eliptike** ose **fjali të fshehta**, siç thuhet zakonisht në literaturën gjuhësore.